

# MUAJI I ARTIT & LETERSISË

## NJË UDHËTIM FRYMËZUES DREJT DIJES DHE KRIJIMTARISË!



Gjatë Muajit të Artit dhe Letërsisë, shkolla jonë u shndërrua në një hapësirë të gjallë leximi, krijimtarie dhe reflektimi, ku fjala, arti dhe mendimi i lirë u bënë ura që lidhën nxënësit me botën e librit dhe të kulturës. Muaji nisi me hapjen simbolike përmes leximit, nën moton domethënëse:

**“Një shkollë që lexon, një komunitet që frymëzon!”.**

Një vend të veçantë në këtë muaj patën konkurset artistike dhe letrare, të cilat u shndërruan në një festë të talentit dhe imagjinatës:

- Konkursi i esesë**, ku nxënësit shprehën mendimet dhe këndvështrimet e tyre mbi tema të ndryshme shoqërore e jetësore;
- Konkursi i vizatimit**, ku ngjyrat dhe format folën më shumë se fjalët;
- Konkursi i poezisë**, ku ndjenjat u kthyen në vargje;
- Konkursi i këngës**, që solli emocione, harmoni dhe energji pozitive.

Këto aktivitete jo vetëm zbuluan talente të reja, por forcuan vetëbesimin e nxënësve dhe i inkurajuan ata të shprehin veten lirshëm përmes artit.



# MUAJI I ARTIT & LETERSISË



Në kuadër të pasurimit kulturor dhe historik, u organizua edhe vizita në Muzeun "Shtëpia me Gjethe", një përvojë e veçantë që i njohu nxënësit me një pjesë të ndjeshme të historisë sonë. Kjo vizitë shërbeu si një mësim i gjallë reflektimi mbi të shkuarën dhe rëndësinë e kujtesës kolektive.

Po ashtu, u zhvillua një bisedë letrare rreth librit "Sikur të isha djalë", ku nxënësit ndanë mendime, interpretime dhe ndjesi personale. Diskutimi i hapur i ndihmoi ata të thellojnë të kuptuarit e veprës dhe të reflektojnë mbi temat e barazisë dhe rolit të individit në shoqëri.



# MUAJI I ARTIT & LETËRSISË



Muaji u pasurua më tej me të ftuarin special, aktorin Irgen Çela, i cili në një bashkëbisedim të ngrohtë dhe frymëzues me nxënësit, ndau përvojën e tij personale dhe profesionale. Ai foli për rrugën drejt suksesit, për sfidat, përkushtimin dhe rëndësinë e të qenit mbi të gjitha një njeri me vlera, integritet dhe pasion për atë që bën. Mesazhi i tij u prit me interes dhe emocion nga nxënësit.



Muaji i Artit dhe Letërsisë u mbyll si një mozaik përvojash të bukura, ku libri, fjala, arti dhe njeriu u bashkuan për të ndërtuar një kulturë shkollore më të pasur, më të ndjeshme dhe më frymëzuese.

Ky muaj na rikujtoi se arti dhe letërsia nuk janë thjesht pjesë e kurrikulës, por udhë drejt formimit të shpirtit dhe mendjes së brezit të ri.